



# Bursa e Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari Edicioni 4

## Kush mund të aplikojë?

Bursa do t'i akordohet një nxënësi nga rrethi i Pogradecit që është duke ndjekur klasën IX dhe në vitin shkollor 2022-2023 do të jetë në vitin e parë të gjimnazit. Bursa është e vlefshme për të mbuluar \$1,000 të tarifës së mësimdhënies në shkollën Nehemia për klasën X. Aplikimet hapen në datën **10 shkurt 2022** dhe mbyllen në datën **31 mars 2022**.

## Kriteret bazë për aplikuesit:

1. Të jetë duke ndjekur klasën e nëntë.
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të ketë notën mesatare mbi 9.00 gjatë të gjitha viteve.
4. Të ketë marrë pjesë në aktivitete vullnetare në shërbim të komunitetit.
5. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze. Njohja e gjuhëve të tjera të huaja është përparësi.
6. Nxënësit fitues nëpër aktivitete akademike si konkurse apo olimpiada të organizuara në nivele të ndryshme (në bazë shkolle, qyteti, rrethi, kombëtare e më tutje) kanë përparësi.

## Dokumentacioni i nevojshëm:

- CV personale (të limitohet në jo më shumë se dy faqe). Për detaje mbi formatin e CV, vizitoni [www.LyhnidaFund.com](http://www.LyhnidaFund.com).
- Fotokopje e dëftesave të klasave V, VI, VII, VIII. Lista e notave për simestrin I, klasa IX.
- Zhvillimi i një eseje argumentuese në anglisht, me të paktën 300 fjalë. Zgjidhni një nga tre temat e mëposhtme:
  - *Is it better to be born rich or smart?*
  - *Is social media good or bad?*
  - *The most memorable experience of my life so far.*
- Tre letra rekomandimi nga mësues apo mentorë që i njohin nxënësit nga afër. Letra duhet të dërgohet me e-mail, direkt nga mësuesi/mentori, në adresën [bursajorgjijajcari@gmail.com](mailto:bursajorgjijajcari@gmail.com). Për detaje mbi formatin e letrave të rekomandimit dhe informacionin që ato duhet të përmbajnë, vizitoni [www.LyhnidaFund.com](http://www.LyhnidaFund.com).
- Fotokopje të diplomave ose certifikatave nga aktivitete të ndryshme jashtëshkollore ose veprimtari vullnetare ku nxënësi ka marrë pjesë.





## Kriteret bazë për akordimin e bursës:

- Performanca akademike
- Intervistë e shkurtër online me aplikantët
- Pjesëmarrja në aktivitete ekstrakurrikulare
- Letra e motivimit / Eseja argumentuese

## Ku mund të aplikoni:

Aplikimet e plota duhet të dërgohen në adresën e e-mailit [bursajorgjijajcari@gmail.com](mailto:bursajorgjijajcari@gmail.com), jo më parë se data **10 shkurt 2022** dhe brenda datës **31 mars 2022**. Të gjitha materialet duhet të dërgohen vetëm në një dokument PDF sipas rendit kronologjik tek **“Dokumentacioni i nevojshëm”**. Për çdo pyetje apo informacion të mëtejshëm na shkruani në adresën e e-mailit [bursajorgjijajcari@gmail.com](mailto:bursajorgjijajcari@gmail.com).

*Për më tepër informacion drejtohuni tek [www.LyhnidaFund.com](http://www.LyhnidaFund.com).*

## Kriteret e vazhdueshmërisë së bursës:

Nxënësi/nxënësja fitues/fituese duhet të raportojë nëpërmjet një letre, rreth 300 fjalë, për ecurinë e tij/saj në shkollë dhe aktivitetet që ai/ajo i mendon të arsyeshme për t’u përmendur. Për këtë pjesë do të kontaktoheni nga stafi ynë gjatë vitit shkollor.

